

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverballi, mbledhja e parë - I, e mbajtur me datën 31.01.2021, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, Vjollca Konjusha, Remzi Shala, Mirlinda Krasniqi, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jetmir Berisha, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Miranda Shabani, Habib Mekolli, Durim Hajra, Shpend Bardiqi, Eglantina Azemi, Hasime Kostanica, Vlonjat Hasani, Aida Alimi, Dardane Sogojeva Shala, Mirsad Qyqalla, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Driton Ademi, Hasan Ismajli dhe dhe Radoman Doderoviq.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkyetar i Komunës, Amir Bullatovci - Drejtor për Administratë, Samir Shahini - Drejtor për Arsim, Arbër Statovci - Drejtor i Inspektoratit dhe Besnik Shala - Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport.

Të tjerë: Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e datës 03.12.2021 dhe 29.12.2021.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Informatë për emërimin e Drejtorëve të Komunës së Fushë-Kosovës.
4. Propozim për shqyrtimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.
5. Propozim për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetjake të vitit 2021, për shpenzim në vitin 2022.
6. Propozim për fillimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale 'Fushë-Kosova'.
7. Propozim për themelimin e tri Drejtorive të reja të Komunës së Fushë-Kosovës.
8. Propozim për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorëve të shkollave në Fushë-Kosovë.
9. Propozim për emërimin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete.
10. Propozim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores Komunale për Transparencë dhe Planit të Veprimit për Transparencë.
11. Propozim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për bashkëpunim me fshatra dhe lagje urbane.

12. Propozim për caktimin e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës për Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës.
13. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, përshëndeti të gjithë të pranishmit në mbledhje, lexoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme me pikën shtesë: Propozimin për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, për mandatin zgjedhor 2021-2025, në mënyrë që të mos vonohemi në këtë proces, pikat tjera janë shqyrtuar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me datën 27.01.2022. Unë dua të ju njoftoj juve, se nga tre vendimet e marra në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur me datën 29.12.2021, të njëjtat janë dërguar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për vlerësim me datën 06.01.2022, vendimi për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa është konfirmuar si vendim në përputhje me dispozitat ligjore, andaj ky komitet i përherëshëm ka filluar punën, lidhur me vendimin për themelimin e Komitetit për Komunitete deri tani nuk kemi përgjigje, është kërkuar dokumentacioni shtesë me nënshkrime për caktimin e përfaqësuesëve të komuniteteve jo shumicë dhe vendimi për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, nuk vlerësohet sipas ligjit, andaj ne kemi punuar me këtë grup punues gjatë muajit janar 2022.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Bazuar në nenin 47, paragrafi 47.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2019, parashihet që të hartohet, 'Rregullorja për bashkëpunim e komunës me vendbanime, fshatra dhe lagje urbane në territorin e komunës', andaj unë në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, propozoi që ta themelojmë Grupin Punues për hartimin e kësaj rregullore dhe t'i zgjedhim përfaqësuesit e fshatrave dhe lagjeve të qytetit, në mënyrë që të mos e shkelim këtë Udhëzim Administrativ, nga viti 2019 e tutje. Nëse pranohet propozimi ynë, ne do ta aprovojmë edhe Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, në të kundërtën jo, sepse ne nuk mund të marrim pjesë në shkeljen e dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ me vetëdije.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Dua të ju njoftoj se unë në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës, do ta zbatoi Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës, ku diskutimet janë të definuara qartë për secilën pikë në shqyrtim, sipas nenit 24 diskutojnë Shefat e Grupeve Parlamentare nga 10 minuta, anëtarët e Kuvendit të Komunës nga 5 minuta dhe 2 është replika vetëm njëherë për pikën e caktuar. Kërkesa e ngritur nga ju nuk është e natyrës urgjente, ne i kemi pikat e parapara të rendit të ditës për shqyrtim dhe pikën shtesë që është urgjente, që ne si komunë të mos vonohemi me vendimin deri në fillim të muajit mars, për përfaqësuesit tonë në Asociacionin e Komunave të Kosovës.

Durim Hajra: Atëherë kjo çështje është e paraparë edhe me Udhëzimin Administrativ, kërkojmë që të hedhni në votim propozimin tonë, sepse është shqetësuese, kur e dijmë 100%, se po bëjmë shkelje.

Artan Asllani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë pas pranimi të materialit për mbledhjen e Kuvendit të Komunës para një jave, lidhur me pikën e nëntë: Propozimin për

emërimin e z. Suhat Ademi në pozitën e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete, në kundërshtim me nenin 8, paragrafi 4, të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2020, menjëherë i kam shkruar Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Zyrtarit të Lartë për Kuvend dhe Komitete, ky mbështetur në regjistrimin zyrtar kam paraqitur statistikën për numrin e banorëve të komuniteteve jo shumicë në komunën tonë, andaj kërkoi që kjo pikë e rendit të ditës të mos shqyrtohet sot.

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Në zgjedhjet e fundit lokale ne jemi regjistruar në Komisionin Qendror Zgjedhor si: Iniciativa e Fushë-Kosovës për Egjiptian dhe Ashkali, aty nuk jemi kontestuar dhe pyetur për përkatësinë etnike, a jemi ashkali apo egjiptian dhe kemi garuar bashkë. Unë e pyes, anëtarin e Kuvendit të Komunës z. Artan Asllani, se kënd e përfaqëson Lista Ndryshe, cilin komunitet?

Shpend Bardiqi: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Nuk ka rëndësi lista e kandidatëve pjesëmarrës në zgjedhje, a është e komunitetit egjiptian apo ashkali, këto janë punë të juaja, këtu duhet të respektohet dhe zbatohet ligji dhe udhëzimi administrativ në fuqi. Qysh keni garuar ju në zgjedhje është problem formal dhe administrativ. Ne e kundërshtojmë komunën kur e bënë ndarjen e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian, mbrojtje në këtë drejtim keni kërkuar edhe ju vetë gjithmonë në periudhën e kaluar, pse kërkonit të ktheheni prapë aty.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Për këtë propozim ka patur konsultime me përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, secili vendim që mirret nga ne dërgohet për vlerësim dhe mbikëqyret nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, nëse nuk është në rregull ai kthehet në rishqyrtim, obligim i yni është, ose rishqyrtimi, ose shfuqizimi i tij. Anëtarin e Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli, ka kërkuar që Kuvendi të informohet për vlerësimin e vendimeve të tij, andaj unë ju informova në fillim dhe këtë do ta bëjmë në vazhdimësi.

Qëndresa Ademi: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Ne në zgjedhje kemi garuar bashkarishtë si: Iniciativë e Fushë-Kosovës për Egjiptian dhe Ashkali, kjo punë u cekë edhe nga Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete z. Bashkim Krasniqi, aty nuk ka patur dallime, kush është ashkali dhe kush egjiptian, ne mendojmë se z. Suhat Ademi është kandidati i duhur për këtë pozitë dhe i përfaqëson të gjitha komunitetet.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Si rrjedhë logjike e ngjarjeve, së pari duhet të ju njoftoi për rekomandimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, pastaj do ta hedh në votim rendin e ditës.

Driton Ademi: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Është kontribut dhe kulturë e një anëtarin të Kuvendit të Komunës sqarimi i kontekstit, në mënyrë që të mos krijojmë precedentë për të ardhmen, pa marrë parasysh urgjencën apo jo, të një propozimi, duhet ta dijmë se propozimi i Lëvizjes Vetëvendosje hidhet në votim.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për vendosje në rendin e ditës: Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për bashkëpunimin e komunës me vendbanime, fshatra dhe lagje urbane në territorin e komunës.

U votua me: katërmëdhjetë vota ‘për’, dymbëdhjetë vota ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë pjesëmarrës në votim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstaton, se Propozimi i paraqitur nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje për formimin e Grupit Punues, për hartimin e Projekt-Rregullores për bashkëpunimin e komunës me vendbanime, fshatra dhe lagje urbane në territorin e komunës kalon dhe së bashku me rendin e ditës së propozuar dhe pikën tjetër shtesë: Propozimin për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, për mandatin zgjedhor 2021-2025, e qiti në votim.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë pjesëmarrës në votim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se rendi i ditës i propozuar për shqyrtim në mbledhjen e sotme me dy pika shtesë: Propozimi për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, për mandatin zgjedhor 2021-2025 dhe

Propozimi për formimin e Grupit Punues, për hartimin e Projekt-Rregullores për bashkëpunimin e komunës me vendbanime, fshatra dhe lagje urbane në territorin e komunës, aprovohen për shqyrtim dhe vendosje.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të datës: 03.12.2021 dhe 29.12.2021.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar/a, anëtar/e të Kuvendit të Komunës, tani i kemi për aprovim: ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës për mandatin zgjedhor 2021-2025 e datës: 03.12.2021 dhe ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës: 29.12.2021. Hap diskutimin për vërejtjet dhe sugjerimet e juaja.

Durim Hajra: Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, kërkojmë që të zbatohet dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Statutit të Komunës dhe Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës, të publikohen audioincizimet e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës për publikun në uebfaqën e komunës, të ngritet niveli i transparencës, e jo të ndodh incizimi i tyre vetëm për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ne kemi vërejtje edhe në përmbajtjen e tyre, diskutimet nuk janë të përfshira në formën e deklaruar, andaj në mungesë të publikimit të audioincizimeve për publikun e gjerë, ne votojmë kundër aprovimit të ekstrakteve të procesverbaleve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Procesverbali dhe ekstrakti kanë dallim ndërmjet tyre, unë më herët kam kërkuar nga Drejtori i Drejtorisë së Administratës me shkrim dhe ne besojmë, që deri në mbledhjen e muajit shkurt, apo më së voni deri në përfundimin e tremujorit të parë të vitit 2022, kjo punë do të rregullohet.

Artan Asllani: Unë nuk dua të komentoj, por në këto dy ekstrakte të procesverbaleve ka gabime teknike.

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Besoi që në një periudhë të afërt kohore, mikrofonat në Sallën e Kuvendit të Komunës do të rregullohen. Lidhur me ekstraktet e procesverbaleve ne jemi ‘kundër’ aprovimit të tyre, për deri sa është duke u shkelur Rregullorja për Punën e Kuvendit të Komunës dhe mungon transparenca për publikun e Komunës së Fushë-

Kosovës, lidhur me punën e organit më të lartë vendimarrës të komunës. Edhe për pyetjet e parashtruara parlamentare, nuk kemi marrë asnjëherë përgjigje substanciale, ose thënë më drejtë, ato nuk i kemi marrë asnjëherë në nivelin e duhur për ecurinë e zgjidhjes së çështjeve të ngritura nga ne.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, lidhur me përmbajtjen e ekstrakteve të procesverbaleve, në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit të Komunës i qiti në votim për aprovim: ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës për mandatin zgjedhor 2021-2025 e datës: 03.12.2021 dhe ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës: 29.12.2021.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota ‘për’, nëntë vota ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e katër anëtarë të Kuvendit të Komunës pjesëmarrës në votim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi I Komunës, me shumicë të votave e aprovon: ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës për mandatin zgjedhor 2021-2025 e datës: 03.12.2021 dhe ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës: 29.12.2021.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’, ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që të parashtrojnë pyetjet e tyre për Ekzekutivin e Komunës.

Durim Hajra: Tani unë i kam disa pyetje për Drejtorët e Drejtorateve të Komunës së Fushë-Kosovës, do të fillojë me Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Mjedis, infrastruktura në lagjen e njohur si Kollonia mungon, për njëet vite atje nuk është investuar fare, aty dora e shtetit nuk vërehet, aty rruga e ‘Llapit’ dhe rruga tjetër ‘Drenica’, që rastësisht ndodhen afër janë në gjendje të keqe, për njëzet e dy vite aty nuk sanohen dëmet e shkaktuara në rrugë. Në rrugën e ‘Dardanisë’, për lëvizjen e lirë të njerëzve dhe automjeteve, e sidomos nxënësve, mungon shënjestimi horizontal dhe vertikal, në afërsi të shkollës ‘Mihal Grameno’, pse nuk po vendosen rrugët njëkahore sipas specifikimeve në ‘Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban’, për qytetin e Fushë-Kosovës, në këtë rrugë ka shpeshë edhe incidente në trafik, i cili është shumë i dendur në këtë pjesë të qytetit. Janë ndarë mjete financiare me buxhet për eliminimin e qenëve endacakë në rrugë, por problemet për qytetarë vazhdojnë. Për rregullimin e rrugës ‘Hajrullah Zymi’ në Fushë-Kosovë, për ata që nuk e dijnë, është fjala për rrugën nga shkolla ‘Mihal Grameno’ deri tek aneksi i shkollës, shkolla e re, për këtë rrugë janë ndarë mjetet financiare dy herë në shumë prej: 80,000.00€, por aty gjendja është e mjerueshme, rruga ka shumë pengesa për lëvizjen e lirë, është thënë këtu në Kuvend, se kemi të bëjme me një Kompani që nuk e ka respektuar kontratën, është hapur tender i ri dhe gjendja ka mbetur po thuaj se e njëjtë. Ndriq-imi publik në disa lagje në Fushë-Kosovë nuk funksionon fare gjatë stinës së dimrit, e njëjta situatë nuk e dijmë, a do të vazhdon njëjtë kështu për katër vite.

Shpend Bardiqi: Unë e kam një pyetje për Drejtoreshën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me ankesat e banorëve të fshatit Bardh i Madh, Graboc i Poshtëm dhe Bardh i Vogël, për orarin e shkurtër të punës në Qendrën e Mjekësisë Familjare në fshatin Bardh i Madh, aty punohet vetëm deri në orën 14:00h, ne kërkojmë që aty orari i punës të jetë 24 orë, ose

së paku të mbahet edhe ndërrimi i dytë deri në orën 19:00h të mbrëmjes, kjo punë do ta zvogëlonte fluksin e pacientëve në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, unë e di se ju do të ankoheni se keni mungesë të stafit mjekësorë. Pyetja tjetër ka të bëjë me ndarjen e shumës së mjeteve financiare prej: 300,000.00€, të ndara nga Qeveria Kurti për rregullimin dhe funksionalizimin e rrjetit të ujësjellësit në lagjen 028, Bardh i Madh, Graboc i Poshtëm dhe fshatra tjera, unë e kam një pyetje bazike, për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, sa mjete financiare planifikohen të ndahen nga komuna, për realizimin e këtij projekti jetikë për nevojat e qytetarëve dhe kur planifikoni të fillon kjo punë në interesin publikë.

Vlonjat Hasani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë tani do të paraqes disa shqetësime të banorëve të fshatit Miradi e Epërme, por shqetësime të njëjta janë edhe nëpër disa fshatra tjera. Ndërtimi i rrugës kryesore në fshatin tonë ka filluar para katër viteve dhe nuk ka përfunduar ende, këtu problem kryesor është shpronësimi i disa pronave, që po paraqiten si pengesë për vazhdimin e projektit, aty rruga është aq e demoluar sa që vetëm emri i ka mbetur rrugë, sepse nuk i plotëson kriteret e rrugës. Ne kërkojmë që Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, t'i zgjidhin problemet me Kompaninë Infracos, të komunikojnë me nivelin qendrorë, të kryhet shpronësimi dhe të vazhdon realizimi i projektit dhe të mos humben këto para. Rruga Lumi në fshatin Miradi e Epërme i ka afër njëqind shtëpi dhe ka shumë probleme me rrjetin e kanalizimit, i cili deri tani nuk është zgjidhur nga komuna, aty është bërë një rrjetë i kanalizimit me vetëiniciativë nga banorët dhe është një sanim i përkohshëm i gjendjes, por mos intervenimi i komunës në këtë rrugë është absurd. Ndriçimi publikë në disa rrugë për arsye të mos mirëmbajtjes së tij nuk funksionon, rruga tek Binari në afërsi të Hekurudhës, ka probleme me rrjetin e pa përfunduar të ujësjellësit, pse në këtë rast Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit nuk është përgjegjëse para banorëve. Janë mbajtur takime të kohë pas kohshme për rregullimin e problemit të varrezave, por nuk ka veprime konkrete nga Drejtoria e Shërbimeve Publike e Mjedisit dhe Drejtoria e Financave e Buxhetit, unë kërkoj që të mbahet një dëgjim publikë për këtë punë dhe të fillohet me adresimin e saj dhe gjetjen e zgjidhjes. Problemi me lumin Graçanka është një sfidë për fshatrat Miradi e Epërme dhe Miradi e Poshtme, nuk është bërë asnjëherë pastrimi si duhet, aty vazhdon kundërmimi që është një shqetësim për banorët e këtyre dy fshatrave, sidomos gjatë stinës së verës, era për shtëpitë e banimit afër lumit është e pa durueshme dhe burim i infeksionit për banorët e zonës, kërkojmë që në këtë drejtim të mirren masa me kohë para stinës së verës. Pyetja tjetër lidhet me fushën arsimin në Komunën e Fushë-Kosovës, në fshatin Miradi e Epërme, ka shumë probleme në procesin arsimorë, kemi mungesë të mësimdhënësve për gjatë gjithë gjysëmvetorit të parë, nxënësit kanë mbetur të pa notuar, në dy lëndë biologji dhe art figurativë, unë nuk di kush ka guximin të notojë këta nxënës. Të nderuarë unë nuk mund të paraqes problemet e grumbulluara me vite, për shtatë minuta, ju jeni njëzet e dy vitë në pushtet, për t'i zgjidhur këto probleme.

Hasan Ismajli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i kam disa pyetje për Drejtorët e Drejtorateve të Komunës, do të filloi me Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, për problemet nëpër shkollat, në Shkollën e Mesme Ekonomike dhe Teknike në Fushë-Kosovë, në objektin e vjetër,

pastrimi bëhet në batanije, mungon ngrohja, nxënësit mërdhihen, nuk mund të koncentrohen në mësim, tauletet janë në gjendje të keqe, këto pohime nuk i kam personale me juve i nderuari drejtor, por veprimet në këtë drejtim duhet të jenë të shpejta, këto janë me fakte, kjo është gjendja reale. Për Drejtorin e Drejtorisë së Inspektoratit, objektet ku bëhen ndërtimet e larta duhet të kenë rrethojën për sigurinë e qytetarëve, ka disa objekte që janë pa rrethoja të tilla, një gjendje e tillë është edhe afër shkollës këtu, ku qasja e nxënësve në rrugë është e rrezikuar. Në fshatin Sllatinë e Vogël, tek pishat, janë bërë hapje të rrugëve të reja, nuk e di a kanë marrë leje në komunë apo jo, kjo duhet të verifikohet dhe kontrollohet me kohë. Nga Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dy aparatura janë rregulluar këtë muaj. Tani e kam një pyetje lidhur me problemet e qytetarëve, për Drejtorin e Drejtorisë së Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës i cili nuk është këtu, por po ju drejtohem juve z. Nënkryetar i Komunës, janë probleme me matjet gjeodezike që janë bërë në vitin 2009 dhe nuk janë realizuar në sistemin operativ të gjeodezisë, ata tani pa fajin e tyre, duhet të japin shumën e mjeteve financiare prej: 150.00€ për gjeodetë dhe plus 30.00€ tjera për taksa në komunë, së paku kërkojmë që këto mjetemos t'iu mirren qytetarëve, pa të drejtë, të mos i dënoni ata me këtë taksë nga komuna.

Etnik Berjani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i kam tre pyetje që ndërlidhen me problemet dhe brengat e banorëve të fshatit Miradi e Epërme, po fillojmë me objektin e Palestrës së Sporteve që është në gjendje të mjerueshme dhe duhet të ketë aty një intervenim për sanimin dhe rregullimin e punëve të mbetura, të mirren masa për vazhdimin e punimeve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Duhet të kryhen punime në rrugën 'Lumi', por edhe të angazhoheni për mbulimin e gropave në rrugën kryesore, deri në zgjidhjen e problemeve pronësore, për vazhdimin e projektit për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës kryesore sipas standardeve dhe projektit ideor. Para tre ditëve ka dalur njoftimi, se do të investohen rreth tridhjetë milion euro në Parkun Industrial në fshatin tonë, pa asnjë dëgjim publik, ju e dini veprimtarinë e bizneseve në fshatin Miradi e Epërme, aty është bërë bazë e stiroporit dhe materialeve tjera të dëmshme, unë jam i ri në moshë, por këto punë nuk duhet të tolerohen, pa kurfarë garancioni për punët që do të kryehen në këtë objekt industrial, që mund të jenë të dëmshme për banorët e fshatit tonë.

Mirsad Qyqalla: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kërkojmë nga Drejtoria e Arsimit që të na njofton për mësimin online, për gjendjen e mësimin online dhe me prezencë fizike në shkollat tona. Për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, për dy javë nuk ka borë, por disa rrugë në fshatra nuk janë pastruar fare dhe ende janë me akull dhe paraqet rrezik për këmbësorët, këto kërkesa duhet t'i përcjellni tek Kompania përgjegjëse për këtë punë dhe të veproni në kohën e duhur. Ndërtimet në Stadiumin e Futbollit në fshatin Bardh i Madh janë ndërprerë, tani kur e kemi edhe këtë bartje kaq të madhe të buxhetit, ekipi i futbollit nuk mund të zhvillojë stërvitjet dhe lojërat kampionale, në mungesë të stadiumit dhe nuk ka asnjë përkrahje nga komuna në këtë planifikim.

Eglantina Azemi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedis, në fshatin Miradi e Poshtme ka gjen i planifikuar të ndërtohet një mbikalim në Programin e Investimeve Publike, por kjo punë është penguar nga një person privat dhe nuk është realizuar, qytetarët aty kanë shumë vështirësi për kalimin e rrugës

magjistrale M9, pyes, kur do të ndërmerren masa konkrete për zgjidhjen e këtij problem jetikë për banorët e zonës?

Dardane Sogojeva Shala: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale por edhe doktorin z. Remzi Shala, kur do të fillon puna në Qendrën e Mjekësisë Familjare në fshatin Sllatinë e Madhe?

Laureat Gojnovci: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë ju falënderoi që si anëtarë të ri të Kuvendit të Komunës, po i paraqitni kërkesat e qytetarëve për zgjidhje, ne këtu e kemi një mundësi të mirë për t'i shprehur qëndrimet dhe kërkesat tona. Pyetja ime ka të bëjë me Drejtorinë e Arsimit, unë kam marrë një email, ku 53 punëtorë në arsim janë jashtë listës së pagave, për periudhën gjashtëmuajore, pyes, cili është plani për pagesat e tyre? Po ashtu dua ta kem një informatë të përgjithshme, për gjendjen e mësimdhënësve dhe nxënësve të infektuar me Coronavirusin Covid - 19?

Drejtori për Arsim: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë dua të japë disa sqarime lidhur me pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, për gjendjen në Shkollën e Mesme të Lartë Ekonomike dhe Teknike, unë e kam vizituar këtë shkollë, fjala është për objektin e vjetër, ku janë edhe nxënësit e komunitetit serbë, aty gjendja nuk është më e mira, ka disa probleme që unë i kam gjetura aty, izolimi jo i mirë, dritaret, nyjet sanitare, të cilat kërkojnë një ndërhyrje urgjente, janë probleme të trashëguara, i kuptoi edhe shqetësimet për shkollën në fshatin Miradi e Epërme, kemi filluar punën në bashkëpunim dhe bashkërendim me Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit dhe do të intervenojmë shpejtë për disa punë, disa të tjera kërkojnë investime që realizohen përmes procedurave të prokurimit, të cilat zgjasin dhe nuk kryhen shpejtë, këto punë do të kryhen brenda këtij viti. Për objektin shkollorë në lagjen e Apollonisë që ka filluar mësimin këtë vitë shkollorë, jemi duke e përgatitur dosjen, me urbanizmin, shërbimet publike dhe financat, sepse nevojitet ta hapim edhe një kod buxhetor për shkollën e re, të gjithë dokumentacionin për regjistrimin e shkollës dhe emërtimin e saj, do ta dërgojmë në Ministrinë e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, e cila sipas ligjit dhe udhëzimit administrative, duhet të vendos brenda një afati prej tre muajve. Lidhur me gjendjen e mësimdhënësve dhe nxënësve të infektuar me Covid - 19, që u parashtruan nga anëtarët e Kuvendit të Komunës z. Laureat Gojnovci dhe z. Mirsad Qyqalla, kjo gjendje ndryshon për ditë, raportimet janë ditore nga shkollat, tani tre shkolla e qytetit i kemi në mësim online, shkolla 'Mihal Grameno' është në mësim online nga dita e mërkure, shkolla në lagjen e Apollonisë nga sot është në mësim online, ndërsa shkolla në lagjen e Dardanisë, sot pritet të kalon në mësim me prezencë fizike në shkollë. Sipas statistikave të ditës së premte, janë nëntë mësimdhënës, pesëdhjetë e nëntë nxënës dhe dymbëdhjetë punëtorë administrativ dhe teknikë. Problem me punëtorët arsimorë jashtë listës së pagave është një sfidë e madhe, ne kemi kërkuar që të na rritet kufiri buxhetorë për mësimdhënës të ri, këto kërkesa i kam dërguar unë në Ministrinë e Arsimit, të njëjtën gjë e kanë bërë edhe paraardhësit e mi, tani ky problem nuk është më problem vetëm për ne dhe Ministrinë e Arsimit, por duhet të rregullohet me projeksione buxhetore nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, kërkesat e tona i kemi dërguar me datën: 17 dhjetor 2021 dhe 28 janar 2022 dhe presim përgjigje.

Hasan Ismajli: Unë e kuptoi që ju jeni në fillim të mandatit tuaj, pyetjet e mia nuk janë personale, shpresoi që këto probleme do të zgjidhen, por nxënësit me jakne në klasë duke dridhur nga të ftohtit nuk mund të mësojnë, ne tani do t'i bartim mbi pesë milion euro për shpenzim, si mjete financiare të pa shpenzuara nga viti i kaluar, kur i kemi edhe pesëdhjetë e tre mësimdhënës jashtë listave të pagave.

Drejtori për Arsim: Për ngrohjen në shkollë, aty në muajin dhjetor 2021, ka ndodhur një havori, aty ngrohja tani është jashtë funksionit, por do ta zgjidhim, aty modeli i ngrohjes është me naftë, me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, është një grantë për energji të gjelbërtë nëpër shkolla dhe ne besojmë, që këtë problem do të rregullojmë. Ne kemi qenë të detyruar që normat e caktuara për psikologë, t'i shfrytëzojmë për mësimdhënës klasorë. Problem me numrin e nxënësve në komunën tonë, vjen nga migrimi madh në qytetin e Fushë-Kosovës dhe ekzistimi i shkollave në Republikën e Kosovës, me nga dy nxënës në një klasë, duhet të ketë edhe ndryshime nga niveli qendrorë në aspektin e politikave në fushën e arsimit.

Vlonjat Hasani: Si do ta zgjidhni problemin me notimin e nxënësve për lëndën e biologjisë, mungesën e mësueses në klasën e dytë. Si do të veproni për rritjen e sigurisë në shkolla, a do të vendosni kamerat nëpër institucionet arsimore?

Fisnik Sllamniku: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Çështja e arsimtarëve që duhet të zëvendësohen, për mbarrëvajtjen e rregullt të procesit edukativo-arsimorë, këtu hyn edhe zëvendësimi i lehonave, ata e kanë koston e tyre financiare, pastaj mësimdhënësit që preken me sëmundjen infektive Covid - 19, të gjitha këto janë sfida, që dalin gjatë një viti shkollorë dhe nuk janë të parapara me buxhet, unë besoi se ne i'a kemi dalur mirë, në këtë vit shkollorë deri tani, edhe përkundër vështirësive që i kemi patur.

Drejtori për Arsim: Problem kemi patur me dy lëndë në gjysmëvjetorin e parë, procedurat për zëvendësimin e mësimdhënësve kanë filluar në muajin gusht 2021, problemet me edukatën fizike dhe lëndën e biologjisë kanë rrjedhur, sepse konkursi është anuluar, një proces i rekrutimit i merrë dyzet e pesë ditë, nëse një mësimdhënës mungon në shkollë, zëvendësimi i parë duhet të bëhet nga Drejtoria e Shkollës, këtë e thotë ligji, pastaj kërkohet shpallja e konkursit publikë nga Drejtoria e Arsimit. Siguria në shkolla përcjellat edhe nga Policia e Kosovës, kjo varet nga kapacitetet e tyre për operim. Ne e kemi patur një thyerje tani në shkollën e fshatit Lismir, e kemi lajmëruar Policinë dhe tani veprimet janë të tyre, ne nuk kemi mundësi të ndërhyjmë.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me punësimin e pesëdhjetë e tre mësimdhënësve, ne e kemi marrë një vendim në Kuvendin e Komunës, që kontratat e tyre të mbulohen sipas modeli gjashtë muaj, me mundësi vazhdimi edhe për gjashtë muaj tjerë.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me pagesën e mësimdhënësve, vendimi për të cilin ju flisni nuk është lejuar të realizohet, ne edhe tani me bartjen e mjeteve financiare të pa shpenzuara në vitin e kaluar, për shpenzim në këtë vitë, do të bartim shumën e mjeteve financiare prej: 300,000.00€ në programin e arsimit.

Jahush Krasniqi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani çështja e objektit shkollorë te ne nuk është e kënaqëshme, kushtet për punë në shkollën ekonomiko-juridike janë minimale, aty ka nevojë për një intervenim urgjentë, që të krijohen kushte adekuate për mësim, si për nxënës, ashtu

edhe për personelin arsimorë, kërkesat tona ne do t'i dorëzojmë edhe në raportin e Drejtorisë së Shkollës, e ftojmë Drejtorinë e Arsimit, që të bënë intervenimin e nevojshëm, për rregullimin e gjendjes në këtë shkollë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë mendoj se aty ku ka nevojë për intervenim emergjentë, kjo duhet të bëhet shpejtë.

Drejtori për Inspektorat: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam marrë detyrën me datën 6 dhjetor të vitit 2021, menjëherë kam filluar të vendos prioritetet në punën tim, kam bërë verifikimin e objekteve në ndërtim e sipër, deri tani i kam gjithësej shtatëdhjetë e katër kërkesa dhe ankesa të natyrave të ndryshme, prej tyre: dhjetë janë për Inspektoren e Tregut, shtatëmbëdhjetë për kushte sanitare dhe dyzet e katër tjera janë nga fusha e ndërtimit, unë kam dalur edhe vetë në teren dhe kam verifikuar rrethojat e sigurisë, tani jemi në kohën e dimrit dhe ndërtimet nuk janë të shumta, andaj ne i kemi hartuar shkresat zyrtare dhe i kam njoftuar të gjithë investitorët e ndërtimeve të larta, për obligimet e tyre specifike që rrjedhin nga Ligji për Ndërtim. Kërkesa juaj për rrethojat e sigurisë nëpër të gjitha objektet kolektive, që janë në fazën e ndërtimeve, vetëm se është shpërndarë në teren. Për rrugën në fshatin Sllatinë e Vogël, do ta shqyrtojmë me seriozitetin më të madhë, do ta verifikojmë cilat rrugë janë me kadastër dhe do të ju përgjigjemi me shkrim.

Shpend Bardiqi: Nuk kemi nevojë që t'i shkurtojmë diskutimet, ne jemi këtu në Kuvend dhe e kemi obligim të mirremi me problemet dhe shqetësimet e qytetarëve, sepse për këtë punë edhe jemi të zgjedhur.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Nuk kemi nevojë që të kemi replika pa nevojë dhe të përsëritemi, unë i ftoi Drejtorët e Drejtorateve të Komunës që të përgjigjen edhe me shkrim.

Pika e tretë (3) - Informatë për emërimin e Drejtorëve të Drejtorateve të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Këtë 'Informatë për emërimet e Drejtorëve të Drejtorateve të Komunës', e ka kërkuar znj. Aida Alimi nga Partia Demokratike e Kosovës, përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje dhe anëtarët e rinjë të Kuvendit të Komunës nga radhët e Lidhjes Demokratike e Kosovës, kjo informatë është dhënë dhe tani jeni të njoftuar me shkrim.

Pika e katërt (4) - Propozim për shqyrtimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim, Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, për të cilin e kemi mbajtur një takim pune me Drejtorët e Drejtorateve të Komunës dhe dy takime pune, me anëtarët e Grupit Punues, me përfaqësim nga të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës. Hap diskutimin.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me pikën për Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, unë kam marrë pjesë në takimin e dytë, në cilësinë e Shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ky plan në pjesën më të madhe është i harmonizuar, me propozimet e Grupit Punues, të cilat janë pranuar dhe janë pjesë e planit të punës,

unë uroi që ky plan, të realizohet gjatë vitit 2022. Secili propozim që nuk është përfshirë në plan, është lënë mundësia që të realizohet përmes pikës së tretë në plan për secilin muaj, andaj aty është mundësia e dërgimit të propozimeve të reja, nga secili prej neve dhe nga Ekzekutivi i Komunës.

Artan Asllani: Në Grupin Punues është ngritur për diskutim çështja e banorëve jo rezidentë në Komunën e Fushë-Kosovës, ky problem është theksuar edhe nga anëtarja e Kuvendit të Komunës znj. Aida Alimi, me realizimin e kësaj pune do të rregulloheshin, edhe shërbimet publike, shërbimet në fushën e arsimit, ku kemi rritje të madhe të numrit të nxënësve dhe shërbime shëndetësore në institucionin kryesorë shëndetësorë, ku kërkojnë shërbime shumica e pacientëve nga komuna jonë dhe vendet tjera. Këtë çështje e ka rregulluar Komuna e prishtinës, andaj unë e përkrah propozimin në fjalë.

Aida Alimi: Për Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, i kemi mbajtur dy takime pune për herë të parë dhe ne ju falënderojmë për këtë qasje juve, i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, ne i kemi dhënë pesë propozime, i pari është: Propozimi për formimin e Grupit Punues për emërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, ky propozim është pranuar, e kemi kërkuar edhe një raport me shkrim për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për shumë arsye që e rëndojnë çështjen e sigurisë në komunën tonë si: vrasjet, vjedhjet dhe dukuritë tjera negative, ky propozim është modifikuar nga ana e juaj, kemi kërkuar që ta hartojmë një Rregullore për dixhitalizimin e të dhënave, e cila është shumë e nevojshme, kjo nuk është pranuar, një Rregullore të brendshme për regjistrimin e banorëve jo rezidentë, për t'i detyruar ata që të regjistrohen, si dhe ndryshimplotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, për të patur mundësi ta kemi gjinekologun dhe pediatrin në Qendrën tonë shëndetësore, të cilit në prill i përfundon kontrata e punës për arsye të moshës së pensionimit të tij, edhe dy propozimet e fundit nuk rejanë pranuar, pa ndonjë sqarim dhe shpjegim. Unë do të jem këmbëngulëse për blerjen e Mamografit sepse mundësitë buxhetore për këtë punë në komunën tonë i kemi.

Remzi Shala: Unë tani dua të sqaroi, se në Statutin unik të vitit 2017 për shërbimet në shëndetësinë primare, për të gjitha Komunitatet e Republikës së Kosovës, kjo punë nuk është lejuar, tani dua ta informoi Kuvendin e Komunës se Statuti i ri me ndryshime të vogla, prapë nuk e parasheh këtë punë, është në proces hartimi i një Udhëzimi Administrativ nga Ministria e Shëndetësisë, parashihet radiologu, ne shpresojmë se mund të zgjidhë disa dilema për komunitat tona. Unë e kam theksuar në shumë takime dhe këtu, se Komuna e Fushë-Kosovës i ka specifikat e veta dhe është e veçantë, andaj duhet të trajtohet ndryshe, por nuk jemi marrë parasysh. Ne i kemi disa probleme, sepse nuk i kemi spitalet rajonale, ku ofrohen shërbimet shëndetësore sekondare, as nuk e kemi Spitalin e Prishtinës, andaj pacientët tanë duhet t'i referojmë direkt në Qendrën Klinike Universitare, ku ofrohen shërbimet shëndetësore terciare. Mjekësia jonë familjare rrezikohet me largimin nga puna të gjinekologut dhe pediatrit, me ligj nuk kemi të drejtë, por duhet të shikojmë të gjitha mundësitë si Kuvend i Komunës, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Shëndetësisë, që ta gjejmë një zgjidhje për çështjen në fjalë. Unë e kam obligim që ta sqaroi se në këtë drejtim,

mund të kemi edhe probleme nëpër gjykata, për punën tonë, sepse nuk jemi profesionistë adekuatë të fushës në fjalë.

Hasan Ismajli: Unë i kam patur katër propozime për planin e punës, e kam kërkuar kodin e veshjes në komunë dhe nëpër shkolla, ka hyrë kodi i etikës, që është në rregull, edhe për propozimet tjera kam marrë sqarime, nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ku disa çështje janë të natyrës administrative, ato plotësohen, por nuk mund të jenë pjesë e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.

Vlonjat Hasani: Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, ne e kemi dhënë kontributin tonë në dy takimet e Grupit Punues, i kemi dhënë propozimet tona, gjithsej gjashtëmbëdhjetë, prej tyre janë pranuar shtatë propozime, disa janë ndryshuar, por thelbi mbetet i njëjtë. Kemi kërkuar ndryshim-plotësimin e Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, që është punë e jona, me ndryshimet ligjore, ne duhet të lirojmë nga pagesat e tatimeve personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, ne e kemi kërkuar rregullimin e kodit etikë për institucionet arsimore, në plan e kemi kodin etike për administratën e komunës, meqë një pjesë e konsiderueshme e propozimeve tona, janë pjesë e planit të punës, ne e përkrahim për aprovim Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.

Driton Ademi: Unë kam marrë pjesë në punën e Grupit Punues për planin e punës, për të krijuar një diversitet politikë nga subjektet politike, ju duhet të dini se grupi i punës nuk merr vendime, vetëm jep rekomandime për procesin e vendimarrjes. Unë e kam thënë qëndrimin tim për hartimin, ndryshimin dhe plotësimin e Rregulloreve dhe vendimeve tona, të cilat vlerësohen nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe kërkohet të rishqyrtohen nga Kuvendi i Komunës. Në takimin e Grupit Punues e kam dhënë sugjerimin tim, që të mirret lista e Projekt-Rregulloreve nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komitetet e Përherëshme dhe Komitetet tjera funksionale, mund të japin propozime profesionale për rregullore. Ne kërkojmë që procesi i ardhshëm për hartimin e planit të punës, të fillon në muajin tetor, të mbahet një diskutim publikë për planin e punës, si dhe ne t'ia bëjmë një vetëvlerësim punës tonë, lidhur me zbatimin e planit të punës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne e kemi sqaruar edhe në takimin e Grupit Punues dhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, se kemi propozuar për hartim njëmbëdhjetë Rregullore dhe katër Plane, të cilët mendojmë se janë të mjaftueshme për vitin tonë të parë, në mandatin tonë zgjedhor. Hartimi i rregulloreve të reja e ka një kosto financiare, këtë e kemi arritur me përfshirjen e propozimeve të përbashkëta të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lëvizjes Vetëvendosje, Partisë Demokratike të Kosovës dhe partive tjera, mbi 50% në planin e punës, duhet vetëm ta kemi një kujdes të shtuar për zbatimin e tij, në plan të punës, po ashtu janë të përfshira edhe propozimet e Ekzekutivit të Komunës, të cilat do të realizohen edhe përmes pikës së tretë në secilin muaj të vitit.

Nënkryetari i Komunës: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Shumë punë që janë përfshirë këtu, nuk ju takojnë juve, rregulloret dhe planet janë punë që rrjedhin nga ligjet sektoriale dhe udhëzimet administrative dhe janë punë e Ekzekutivit të Komunës, edhe Legjislativi i Komunës e ka pjesën e vetë, unë i dëgjova me kujdes kërkesat dhe sqarimet, e elaboruara nga z. Remzi Shala

dhe znj. Aida Alimi, ne do t'i bëjmë kërkesat tona, por nuk mund të ndërhyjmë në kompetencat e tjetër kujt, sepse ato caktohen me ligje.

Aida Alimi: Ne kemi të drejtë të ndërhyjmë dhe të kërkojmë zgjidhje, kur atakohen fëmijët dhe nënat tona, edhe ne e kemi përgjegjësinë tonë në këtë drejtim, andaj duhet të veprojmë.

Nënkryetari i Komunës: Si kërkesa për zgjidhje po, por nuk mund ta ndryshojmë Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, sepse ai është unik për shëndetësinë primare.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për miratim 'Planin e Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2022'.

U votua me: njëzet e katër vota 'për', asnjë 'kundër' dhe tre abstenime, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e miraton:

Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2022.

Pika e pestë (5) - Propozim për bartjen e mjeteve financiare të pashpenzuara në vitin 2021, për shpenzim në vitin 2022.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Drejtori i Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit, nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me arsye, sepse i ka ndërruar jëtë prindi i tij, andaj unë në emrin tim dhe në emër të subjekteve politike i shprehim ngushtëllime. Tani e kemi për shqyrtim 'Propozimin për bartjen e mjeteve financiare të pashpenzuara në vitin 2021, për shpenzim në vitin 2022', ju ftoi që të na jepni sqarime shtesë.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Falënderit i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës dhe përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, atëherë bartja e mjeteve financiare të pa shpenzuara të vitit 2021, për shpenzim në vitin 2022, realizohet në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe Ligjit për buxhetin, neni 19, ne propozojmë që të bëhet kjo rindarje e fondeve publike, prej fondit burimorë 21 dhe 22, për kategorinë ekonomike të mallërave dhe shërbimeve shumë e mjeteve financiare për bartje është: 504,445.52€, për kategorinë ekonomike të subvencioneve dhe transfereve shuma e mjeteve financiare për bartje është: 508,768.69€ dhe në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale shuma e mjeteve financiare për bartje është: 3,994,293.20€. Arsyet e rritjes së shumës së mjeteve financiare në: 5,007,000.00€, është se ne e kemi bërë një rritje të hyrave vetjake, si parashikim në mandatin e kaluar prej mbi dy milion euro, në kuadër të kësaj shuma hyn edhe mjetet financiare të kontraktuara prej: 733,000.00€ dhe mjetet e grumbulluara në tremujorin e fundit të vitit 2021, të cilat nuk mund të shpenzohen dhe barten.

Durim Hajra: Lidhur me bartjen e mjeteve financiare të pa shpenzuara në buxhetin e komunës kemi folur shumë, ne si përfaqësues të Lëvizjes Vetëvendosje, në të kaluarën, i kemi dhënë sugjerimet dhe qëndrimet tona, kjo punë po përsëritet prapë, kanë qenë dy milion, pastaj tre milion, por tani shuma e mjeteve financiare është pesë milion dhe është përtej secilit parashikim logjikë. Ne kemi kritikuar, por e vërteta është, se vërejtjet tona kanë qenë të arsyeshme, por bartja e pesë

milioneve për shpenzim në vitin vijues, kur buxhetin total e kemi pak më shumë se dhjetë milion, shuma për bartje krahasuar me buxhetin, është 46% e buxhetit, kjo është jo keqëplanifikim, por keqëmenaxhim ashtu siç kemi thënë, me fondet publike në dispozicion, kur nevojat për investime në arsim dhe shëndetësi janë shumë të mëdha. Ju nuk i keni planifikuar si duhet, as të hyrat vetjake, ju jeni në pushtet për njëzet vjetë dhe ende nuk i'a keni marrë tahminin, sa mjete financiare duhet të planifikohen. Ju mundoheni të arsyetoheni se fajet janë tek operatorët ekonomik, të pa ndërgjegjshëm, por kjo po ndodh për tre vite radhazi. Duke filluar që nga viti 2019, ju e vendosni në buxhetin e komunës, ndërtimin e shkollës në Nakaradë dhe i mashtrojnë qytetarët e zonës, projekti nuk realizohet asnjëherë, pastaj theksoni se këto punë opozita i deklaronte këto për inate politike, ne po flasim për dokumentet e prezantuara në buxhet, me fakte. Në kohën kur buxhetin vjetor në të njëjtin vitë e keni 10,992,686.00€, barten të pa shpenzuara mjetet financiare në shumë prej: 5,007,507.41€, janë grumbulluar më shumë se planifikimi dy milion euro, atëherë nuk është për tu çuditur se një ditë, do të bartet i gjithë buxheti dhe do të thoni na falni, nuk ka asnjë investim publikë, e dyta është huqja totale nga tre milion, në pesë million euro, ku barten për investime publike 3.9 milion euro, kështu që pa hyrë fare në detajizime, tregon vetë se investimet publike kanë qenë minimale, andaj e kemi këtë gjendje në arsim dhe shëndetësi. Unë nuk mundem këtu për dhjetë minuta të paraqes të gjithë dështimin e juaj, në ekzekutimin e buxhetit të komunës. Unë këtu flas në bazë të letrave dhe dokumentave që na dorëzohen për shqyrtim dhe aprovim nga ana e juaj, e kemi shumën e mjeteve financiare prej: 151,726.05€ ndahen për zhavor, mungojnë investimet publike në shëndetësi, nëpër shkolla, por kemi disa projekte të asfaltimit dhe zhavorin, pastaj shembull është rruga 'Hajrullah Zymi' në Fushë-Kosovë, është asfaltuar dy herë, por prapë në atë rrugë, kemi gropa në rrugë.

Artan Asllani: Kur i kemi themeluar dy Komitetet e Përherëshme, në mbledhjen e kaluar Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, jam konsultuar më doktor Remin, jam sqaruar se Kuvendet e Komunave, që i kanë nga njëzet e një deri në tridhjetë e një anëtarë, në Komitetin për Politikë dhe Financa i kanë nga shtatë anëtarë, tani ne nuk e kemi asnjë përfaqësues në këtë komitet esencial për zhvillimin e komunës. Këtu po barten rreth katër milion euro për shpenzim në projekte kapitale dhe nuk është asnjë projekt, që duhet të investohet në lagjet e komuniteteve. Tani nga Qeveria e Kosovës, janë ndarë 300,000.00€ për rregullimin e rrjetit të ujësjellësit në lagjet 028 dhe 029, këto lagje nuk janë të mbuluara mirë me shpenzime publike, ne në mungesë të një ngastre kadastrale, e kemi humbur ndërtimin e një Palestre të Sportit, kjo zonë e qytetit tonë meriton ta ketë, një qasje ndryshe, sa i përket investimeve publike.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Kjo është bartje e buxhetit të komunës, buxheti i vitit 2022 është hartuar në bazë të kërkesave të juaja, këto janë projektet aktuale, të cilat me përqindje të realizimit të tyre do t'i keni në raportin financiar për buxhetin e shpenzuar.

Aida Alimi: Ne nuk mund ta përkrahim një keqëplanifikim dhe keqëmbikëqyrje të projekteve publike, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, vetëm për projektin e ndërtimit të sheshit në lagjen 'Dardania' në Fushë-Kosovë, është një shumë e mjeteve financiare prej: 147,758.27€, ndërsa me buxhet kanë qenë të planifikuara rreth katërqindmijë euro, aty nuk është investuar asgjë, në komunën tonë mungon mbikëqyrja e projekteve, andaj kemi shumë dështime.

Qëndresa Ademi: Tani e kemi për shqyrtim dhe analizim bartjen e mjeteve financiare të vitit 2021, në vitin 2022, pyes, a ka planifikuar komuna jonë të ndihmojë shtresat më të varfëra të popullsisë, që janë në gjendje të vështirë sociale, për blerjen e barnave, transportin e nxënësve në shkollë, meqë buxheti nga niveli qendror, ende nuk është caktuar për këtë vitë, për këto çështje jetike për banorët tanë.

Habib Mekolli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne këtë bartje të madhe të mjeteve financiare të pa shpenzuara në vitin e kaluar, e kemi shqyrtuar dhe analizuar në Grupin tonë parlamentarë, me kolegët z. Hajra dhe të tjerët, ku i kemi shprehur brengat e qytetarëve dhe obligimet që kemi ne ndaj tyre, si përfaqësues të zgjedhur për mbrojtjen e interesave të popullatës sonë. Unë e kam takuar rastësisht një qytetarë, pasi e kam marrë rendin e ditës për mbledhje, kam biseduar me të për këtë bartje të buxhetit prej pesë milionëve, ne qytetarët tanë po i ndëshkojmë sipas ligjit për vonesën e tatimit në pronë, me kamata shtesë, por nuk po e kemi një përgjigje të thukët dhe përmbytësore, nga Drejtori i Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit, por edhe drejtorët tjerë të komunës, pse po barten të gjitha këto mjete financiare dhe kush duhet të përgjigjet për plotësimin e nevojave të qytetarëve, për mos realizimin e buxhetit, sepse qytetari kur vonohet dënohet, ndërsa komuna kur vonohet në realizimin e detyrave të saja jo.

Remzi Shala: Lidhur me bartjen e mjeteve financiare të pa shpenzuara nga viti 2021, në vitin 2022, shpjegimet, pse ka ndodhur kështu u dhanë nga Drejtori i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, ku kemi patur rritje më të madhe të hyrave vetjake, nga investimet në ndërtime, grumbullimin e mjeteve financiare në tremujorin e fundit të vitit, që nuk mund të shpenzohen, por të hyrat vetjake mund të barten për shpenzim në vitin 2022, ka patur probleme edhe me pandeminë, u çekën nga Nënkryetari i Komunës më herët, edhe ankesat dhe vonesat e shkaktuara nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, të gjithë këta faktorë ndikojnë në formën e vetë në realizimin e buxhetit. Disa nga projektet e planifikuara në vitin e kaluar barten për realizim në vitin e ardhshëm, këtë po e pasqyrojmë edhe tabela e dokumentit financiar, disa projekte janë të kontraktuara dhe do të vazhdohet me realizimin e tyre.

Shpend Bardiqi: Kur në komunën tonë janë të gjitha këto telashe, me të tepruar mjetet financiare si të pa shpenzuara është skandaloze, kur problemet në shkollë janë evidente, me numrin e nxënësve, pastrimi në shkollë bëhet me batanije, në qytet nuk e kemi asnjë parkë apo sheshë të rregulluar, ambulancat nëpër fshatra janë jo funksionale, arsimtarët pa paga, e shumë probleme tjera, për fillim bartja ka qenë tre milion euro, është rritur tani, vetëm në arsim dhe shëndetësi, barten 500,000.00€, sepse ju nuk keni kurrfarë ideje për investime publike në këta dy sektorë. Për gjendjen e krijuar në shkollë dhe ambulancat, kur barten mbi pesë milion euro dhe nuk investohet, marre duhet me ju ardhur, juve që jeni në qeverisje me vite në komunën tonë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ju i nderuar nuk keni të drejtë të nxjerrni pohime të tilla, sepse vlerësimin për punë e japin qytetarët në zgjedhje dhe ju e dini rezultatin e fundit zgjedhor, andaj unë kërkoj nga ju mirëkuptim, në atë mënyrë që ta ruani, fjalorin tuaj dhe të mos përdorni shprehje jo adekuata në Kuvendin e Komunës, sepse nocioni marre e ka edhe karakterin tjetër të fjalisë, kuptimin etikë, ju lutem bëhuni intelektual dhe gjeni shprehje tjera, unë jam që të ngritni kritika, por jo të ofendonin në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Mirsad Qyqalla: Këta i kanë fituar zgjedhjet unë i ftoi të gjithë, që ta ruajmë gjuhën parlamentare, thuhet se janë grumbulluar më shumë dy milion euro, unë pyes, a janë lëshuar më shumë leje të ndërtimit, apo nga cili rezultat ka ardhur kjo shumë e mjeteve financiare. Ne e kemi analizuar tabelën me mjetet financiare për projekte kapitale, por këtu nuk është se mund të mirret si arsyetim situata me pandeminë, sepse shumicë e punëve dhe projekteve publike nuk kanë filluar fare. Nuk mund të arsyetohet bartja e mjeteve financiare prej pesë milion eurove, kur paraqiten probleme reale në arsim, që u cekën edhe nga personi adekuatë, që është profesor në shkollë, kolegu z. Jahush Krasniqi. Buxheti në këtë rastë është i keqëplanifikuar dhe pa mbikëqyrje të shpenzimeve, po thuani ka ndodhur Kovid - 19, problem këtu është se mungon puna. Pa hyre fare në analizimin dhe vlerësimin e secilës shumë, me shifra, ne jemi të pakënaqur me realizimin e buxhetit, kur nevojat janë shumë të mëdha, andaj si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, jemi kundër bartjes së këtij buxheti për arsye të mos punës.

Driton Ademi: Shqyrtimi i këtij propozimi e ka një kronologji të rrjedhjes së ngjarjeve, unë është hera e parë që e kam votuar buxhetin e komunës, edhe suficiti, edhe deficit buxhetor nuk janë të mira, në rastin konkret Zyrtari Kryesor Financiar, i ka fituar zgjedhjet, ne i kemi dy role që duhet t'i kuptojmë drejtë, rolin vendimarrës dhe rolin mbikëqyrës, e jo të thuhet marre, sepse nuk është marre fare, kur në aspektin kohor jeni në rregull, me kalendarin buxhetor, funksioni i financave është funksion administrativ, që buron nga tavani i shpenzimeve buxhetore, si dhe alokimet e buxhetit që bëhen për çdo tre muaj, shpenzimet në katërmujorin e fundit nga të hyrat vetjake janë minimale, ato mjete financiare barten për shpenzim në vitin e ardhshëm, ne këtu jemi arenë e mbikëqyrjes, përmes raportimeve të rregullta financiare, që parashihen më ligjë.

Nënkryetari i Komunës: Planifikimi i buxhetit në fillim bëhet më Kornizën Afatmesme Buxhetore, ku caktohet kufiri për grumbullimin e të hyrave vetjake, ju duhet ta bëni dallimin substancial, ndërmjet buxheti fiks dhe buxhetit fleksibil. Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, neve na ka caktuar që t'i mbledhim 2,000,000.00€, ne i kemi mbledhur 4,000,000.00€, ku prej tyre, shuma prej 1,200,000.00€, janë mbledhur vetëm në tremujorin e fundit të vitit dhe nuk mund të alokohen për shpenzim, kur kësaj i shtohen edhe gjatë trafikut, shuma e mjeteve financiare prej: 700,000.00€, për projekte të kontraktuara që do të realizohen arrin në 2,200,000.00€, pastaj situata me pandeminë, operatorët ekonomik të pa përgjegjshëm, nuk mund të quani keqëplanifikim, e të thuani se buxheti është shpenzuar vetëm 54%, sepse komuna funksionon në bazë të potencialit të saj dhe parametrave buxhetor në dispozicion. Mjetet financiare janë të shpërndara nëpër projekte kapitale, të kontraktuara një pjesë e tyre, duhet të barten dhe të vazhdojmë me realizimin e projekteve publike në këtë vitë.

Durim Hajra: Unë e kam një replikë në lidhje me fjalimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Driton Ademi, që po na drejtohet neve me, ne dhe ata, por po harroni se shuma nga dy milion euro në fillim të mandatit tonë, është rritur në tre milion euro, tani është bërë pesë milion, kjo është mos punë e Ekzekutivit të Komunës, ne dijmë që tani, ju politikisht jeni afër Ekzekutivit të Komunës dhe po flisni në këtë mënyrë, rregulloret dhe raportimet për buxhetin parashihen me ligje dhe ne i dijmë shumë mirë ato. Ne si Lëvizje Vetëvendosje i kemi dhënë tridhjetë e dy propozime për buxhet, nuk është marrë parasysh asnjë. Po përmendet vazhdimisht mbikëqyrja e projekteve, po

operatorët ekonomik nuk duhet të jenë më të fortë se ne, sepse neve na mbron ligji. Nënkryetari i Komunës po thotë buxheti fleksibil, të nderuar ju jeni pa planifikim fare këtu, nuk është ky kundër argument, po mundoheni ta zbutni pak edhe me pandeminë, por pandemia ka qenë e panjohur për ne dhe ka shkaktuar vështirësi në vitin 2020, e jo në edhe në vitin 2021. Po ashtu ju nuk e keni as një databazë, për të vendosur në listën e zezë Kompanitë e pa përgjegjësime, që nuk i kryejnë punët si duhet.

Driton Ademi: Të nderuar kolegë Nisma Socialdemokrate, është subjekt politikë dhe e synon qeverisjen, ne nuk jemi Organizatë Jo Qeveritare, debatet publike për buxhetin mbahen, përpilohet procesverbali, sqarohet çka përfshihet dhe çka jo, po ashtu ju e dini se qytetari ka vendosur me votën e tij të lirë, në muajin tetor dhe nëntor 2021, për qeverisjen e ardhshme katërvjeçare. Financat Publike janë të sakta dhe bazohen në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe Ligjin për financimin e pushtetit lokal, ju nuk po dëgjoni saktë, unë e thashë qartë, se edhe suficiti, edhe deficit nuk janë të mira, e rrezikojnë qëndrueshmërinë buxhetore, por puna e Kontrollit të buxhetit është punë e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe Zyrtarit Kryesor Administrativ. Zyra e Auditimit të Brendshëm dhe Zyra e Prokurimit, janë në varësi të Zyrtarit Kryesor Financiar dhe këtu ligji nuk ndryshon për askënd.

Vlonjat Hasani: Bartja e buxhetit të pa shpenzuar në shumë e mjeteve financiare prej: 5,007,507.41€, paraqet parregullësi, mangësi në investime publike dhe keqëplanifikim. Qytetarët kanë nevoja elementare për shpenzimin e buxhetit, mos shpenzimi i tij është marre, madje unë këtu po e përdori edhe një hadith, jo që është marre, por ju që e bëni këtë edhe duhet të marroheni, me mjetet financiare që po i bartni, ju kështu keni vepruar për katër vjet pa investime publike substanciale dhe haptaz, e keni keqpërdorë besimin e tyre me mos punë. Ka shumë probleme në arsim, infrastrukturë nëpër fshatra, mungesë të investimeve në fushën e ambientit dhe ju i bartni pesë milion euro, kjo është një dështim dhe me pak fjalë është marre.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë si Kryesues i Kuvendit të Komunës jam imam në Xhami, por nuk do të përdori vetë ajete kuranore në Kuvendin e Komunës dhe nuk do të ju lejojë, as juve, të përdorni hadithe këtu, sepse këtu jemi për të shpjeguar dhe sqaruar çështjet në aspektin profesional.

Migjen Kolshi: Unë dua të lidhem me diskutimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Driton Ademi, për katër vjet ju asnjëherë nuk keni marrë pjesë në dëgjimet buxhetore, aty kam marrë pjesë unë dhe z. Durim Hajra, në këto dëgjime publike për buxhetin unë i kam parashtruar për zgjidhje kërkesat e banorëve të fshatit Harilaç, sikur: Propozimin për rrethojën e varrezave, i cili është futur në buxhet, por nuk është realizuar kurrë. Si ta votoi unë këtë bartje të buxhetit, kur pesëdhjetë e tre punëtorë në arsim, janë pa paga dhe nuk parashihet asnjë shumë për këtë punë, ne e kemi marrë një vendim për punëtorë në arsim, pyes, pse nuk është realizuar ai vendim? Këtu është një e mirë të nderuarë kolegë, sepse këta grantin qeveritarë e shpenzojnë, ndërsa të hyrat vetjake i bartin në vitin e ardhshëm, meqë kjo lejohet me ligj, unë e kam përcjellur njësoi ka vepruar edhe Komuna e Prishtinës, një herë i ka bartur dhjetë milion euro dhe herën tjetër njëzet milion euro. Në buxhetin e vitit 2021, kanë qenë të planifikuara për shpenzim, për shtruarjen e rrugëve më zhavor 90,000.00€, nga del tani për bartje shuma e mjeteve financiare prej:

151,726.00€ për këtë projekt, i cili është i pa arsyeshëm. Në vitin e kaluar kanë qenë të planifikuara të ndërtohen dhe vendosen në rrethrotullim dy shtatore, e presidentit Dr. Ibrahim Rugova dhe e Komandantit Legjendarë Adem Jashari, këtu po barten 107,161.19€. Po ashtu parashihet, të barten mjete financiare për ndërtimin e Palestrës së Sporteve në fshatin Sllatinë e Vogël në shumë prej: 500,000.00€, ndërtimi i kësaj Palestre të Sporteve në fshatin Miradi e Poshtme më herët ka dështur, andaj kujdesuni që të mos dështoni prapë.

Remzi Shala: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e kam një lutje të singertë, termi marre dhe të ngjajshme të mos përdoren, sepse marrja dhe marruhuni nuk janë terme për përdorim në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, ka terminologji tjetër që mund ta përdorni si: pa përgjegjësi, keqëplanifikim, keqëmenaxhim e tjera. Përdorimi i këtij termi në aspektin etikë është fyes, andaj ky termë si jo adekuatë të mos përsëritet, sepse ne këtu jemi njëzet e shtatë anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Hasan Ismajli: Unë pajtohem se ka vend për kritika këtu, por nuk mund ta quaj keqëmenaxhim të buxhetit, pa fakte, mjetet financiare prapë do të barten, por ne nuk duhet të lejojmë që të përdoren terme fyese në Kuvend. Kush vjedhë përgjigjet para ligjit, vlerësimin për secilin prej neve e kanë dhënë qytetarët në zgjedhje, andaj ne duhet të sjellemi mirë, me seriozitet dhe kulturë.

Jahush Krasniqi: Kuvendi i Komunës është vend ku debatohet në suaza të normave, nuk duhet të drejtohet gishti ndaj neve, andaj kini kujdes të nderuarë kolegë, se si po silleni.

Durim Hajra: Fokusi ishte tek debati për bartjen e mjeteve financiare, është çështje emocionale, mos u kapni për fjale, marre, keqëmenaxhim, turp të keni, dihet kujt i referohet.

Mirlinda Krasniqi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Përdorimi i termit jo adekuatë dhe jo etikë dhe fyes, që ndërlidhet edhe në aspekte tjera të shprehjes, nuk duhet të përdoret nga kolegët, andaj duhet të distancoheni nga kjo shprehje edhe ju, nuk duhet ta bëni dhe përdoreni asnjëherë në sallën e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani ta përmbylim këtë situatë, të mos tejkaloheni emër për emër, sepse ne mund t'i përdorim edhe mekanizmat që i ka Rregullorja për Punën e Kuvendit të Komunës, andaj kërkoj që të silleni si intelektual dhe me argumente, si dhe ta keni një qasje të mirë në fjalorin e shprehur. Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetjake të vitit 2021, për shpenzim në vitin 2022'.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', dhjetë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi, se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetjake të vitit 2021, për shpenzim në vitin 2022' dhe mori:

V E N D I M

1. Lejohet bartja e mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2021, në vitin fiskal 2022 në shumë të përgjithshme prej 5,007,507.41€, sipas propozimit me dokumentin financiar të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 38, të datës 20.01.2022.

2. Bartja e mjeteve financiare nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara është për kategoritë ekonomike të shpenzimeve si vijon:
 - 2.1 Për kategorinë ekonomike mallra e shërbime shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 504,445.52€;
 - 2.2 Për kategorinë ekonomike subvencione shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 508,768.69€;
 - 2.3 Për kategorinë ekonomike investime kapitale shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 3,994,293.20€.
3. Shpërndarja e mjeteve financiare të bartura sipas përshkrimit bazik në pikën një dhe dy të vendimit është e detajizuar dhe e përshkruar, për secilin shpenzim në dokumentin financiar që është pjesë e këtij vendimi.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për fillimin e procedurave për themelimin e ndërmarrjes Publike Lokale ‘Fushë-Kosova’.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për fillimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale ‘Fushë-Kosova’, ftoi Nënkyetarin e Komunës që të na jap sqarime.

Nënkyetari i Komunës: Materialin e domosdoshëm për fillimin e procedurave e keni ju tani, shumë Komuna të Kosovës kanë trashëguar dhe themeluar ndërmarrje publike lokale, këtë punë e kemi patur si ide edhe para dy viteve, por unë mendoj se tani nevojat publike komunale dhe zgjerimi i qytetit të Fushë-Kosovës, me ndërtimet e larta, nevoja për hapësira rekreative, pastrimi i trotuareve dhe parqeve, oborreve të shkollave dhe ambulantave, hyrje/daljet e banesave kolektive që do të bëhet më vonë, e arsyetojnë nevojën për fillimin e kësaj pune. Ne tani duhet ta marrim një vendim për fillimin e procedurave dhe ndarjen e kapitalit themeltar, sikur që parashihet me ligj në shumën e mjeteve financiare prej: 10,000.00€. Në vazhdim ne do ta përgatitim edhe raportin e arsyeshmërisë, planin e biznesit dhe planin e buxhetit, i cili do të dërgohet për shqyrtim në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe pastaj dokumentacioni ynë, do të vlerësohet nga një Komision Ndërmnistrorë dhe në fund vendimi përfundimtarë mirret nga Qeveria e Kosovës, e tëra procedura ne mendojmë se mund të zgjatë gjashtë muaj.

Shpend Bardiqi: Fillimisht nga Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje, propozimi për themelimin e ndërmarrjes publike lokale, para hartimit të rregullores nuk kalon. Kjo punë ka qenë edhe koncept-ide e arsyetuar e kandidatit tonë për Kryetar të Komunës z. Enver Bajçinca, por tani e ka marrë kundërkandidati i tij Burim Berisha, tani Kryetar i Komunës, i cili në fushatën elektorale nuk e ka patur këtë ide fare. Në materialin e propozuar nuk ka sqarime të mjaftueshme, si do të funksionon kjo ndërmarrje, cili do të jetë bordi i saj menaxhues dhe drejtues, kujt i jep llogari, sa do të jetë buxheti i saj, një Kompani e tillë duhet të jetë serioze, meqë këto sqarime ne tani nuk i kemi, do të abstenojmë.

Nënkyetari i Komunës: Tani fushata zgjedhore ka përfunduar dhe nuk kemi nevojë të mirremi shumë me të. Kompania banesore për mirëmbajtje, mund ta krijojnë vetë njësitë banesore, ato mund ta bëjnë organizimin e tyre, këtë ua mundëson ligji. Kandidati juaj për Kryetar të Komunës z. Enver Bajçinca nuk e sqaruar, si funksionon një Shoqëri Aksionare, ajo nuk funksionon me një

kapital të vogël. Vetë qytetarët mund të organizohen për të pastruar hyrje/daljet e banesave të tyre, kjo punë është e rregulluar për ndërtimet kolektive.

Driton Ademi: Ne e përkrahim për aprovim 'Propozimin për fillimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale 'Fushë-Kosova', ky është një momentë kyq, që të përkrahen qytetarët në ofrimin e këtyre shërbimeve publike, një ndërmarrje publike lokale funksionon si shoqëri aksionare, në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, organizimi i saj bëhet në bazë të modelit të qeverisjes korporative. Ky propozim dërgohet në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe vendoset nga një Komision Ndërmnistrorë. Kuvendi duhet ta ketë një mbikëqyrje sipas ligjit mbi këtë ndërmarrje lokale, përmes raportimeve vjetore. Nisma Socialdemokrate e kupton mirë këtë punë, sepse është pjesë e politikave të majta, bile kjo punë nuk i përgjigjet partive politike me orientim të djathtë.

Hasan Ismajli: Unë kam marrë pjesë në gjashtë debate televizive, me kandidatët e tjerë për Kryetar të Komunës, kandidati juaj ka thënë se do të realizon një projekt të vendosjes së makinave me ashensorë në një parking shumëkatësh. Ne mendojmë se krijimi i një ndërmarrje për ngrohje qendrore dhe mirëmbajtjen e banesave, do të ishte e mirë se ardhur, meqë kemi shumë objekte kolektive në qytetin tonë, tani qytetarët i paguajnë 20.00€ për mirëmbajtjen e ashensorëve dhe pastrim, por kjo punë ka kosto të lartë financiare dhe nuk po funksionon mirë, andaj ne e përkrahim një program të tillë të komunës, për fillimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale 'Fushë-Kosova'.

Fisnik Sllamniku: Unë këtu do të diskutoi pak në rolin e qytetarit dhe si punëtorë në institucionet arsimore, kjo ndërmarrje do të paraqiste një ndihmë të madhe për institucionet arsimore dhe shëndetësore, si dhe do të zgjidhte shumë probleme, nëse do të mirreshin përgjegjësitë për pastrimin e oborreve të shkollave, kjo është shumë e nevojshme të bëhet në fshatrat tona, unë po flas për fshatin Vragoli, aty ku punojë, por e njëjta vlenë edhe për shkollat e qytetit të Fushë-Kosovës. Ne mendojmë se, me këtë punë do të përmirësohet edhe imazhi i shkollave tona.

Mirsad Qyqalla: Ne këtë punë e kemi mbështetur si ide fillestare, edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, por nuk kemi marrë aty sqarime të mjaftueshme, kemi kërkuar sqarime shtesë nga Nënkryetari i Komunës. Unë mendoj se në këtë proces jemi shumë vonë, deri në jetësimin e punës në teren, ne parimisht si Grup Parlamentarë i Partisë Demokratike të Kosovës jemi për fillimin e punës për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale në Fushë-Kosovë.

Artan Asllani: Unë në takimin e parë të Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor për Punën e Kuvendit të Komunës për vitin 2022, e kam parë se në rendin e ditës, është edhe kjo ndërmarrje, që do ta zvogëlonte koston financiare për qytetarët e Fushë-Kosovës për mirëmbajtjen e banesave të tyre, do të punësoheshin edhe një numër i qytetarëve tanë, andaj ne e përkrahim në parim këtë propozim.

Durim Hajra: Unë do të jem i shkurtër në diskutimin tim, sepse qëndrimin tonë e paraqiti kolegu z. Shpend Bardiqi, nëse kjo punë ndikon në zvogëlimin e koston financiare të mirëmbajtjes për qytetarë, nga shuma e tanishme prej: 20.00€, në 5 apo 6€, do ta keni votën time dhe përkrahjen tonë si opozitë, por kjo punë nuk është nisur si duhet, mungon komunikimi me Ministrinë e

Zhvillimit Ekonomik, informatat tani janë të mangëta, meqë ju nuk po i ndjekni, procedurat ashtu siç parashihet, ne tani do të abstenojmë.

Nënkryetari i Komunës: Tarifat ne nuk i caktojmë tani, materiali i plotë do të dorëzohet në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, p.sh ne do të përshkruajmë saktë sipërfaqet e oborreve të shkollave, sa janë nevojat për shërbime publike në shkolla, ndërsa për objektet kolektive të banimit, duhet ta bëjmë një Kompani tjetër.

Jetmir Berisha: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Grupi Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në parim e përkrah këtë iniciativë të qëlluar, e cila është shumë e nevojshme për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës, për krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve publike komunale, sa më të mira për ata dhe me një kosto të arsyeshme financiare për qytetarët. Ne shohim shumë postime në internet, për vendndodhjen e mbeturinave për rrugën e Dardanisë, mbeturinave inertë në fshatin Kuzmin, por kjo punë don angazhim të madhë dhe vetëdijësim të shoqërisë. Unë mendoj se për këtë ndërmarrje lokale duhet të krijohet një plan i mirë i biznesit, një plani operativ për veprim në teren. Struktura organizative e saj, përbëhet nga dy anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe një përfaqësues nga Kryetari i Komunës, kështu krijohet bordi drejtues, me funksionalizimin e kësaj punë Ekzekutivi i Komunës do të marrë shumë poena. Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për fillimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale 'Fushë-Kosova' dhe lejimin e kapitalit fillestar në shumën e mjeteve financiare prej: 10,000.00€.

U votua me: njëzet vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe gjashtë abstenime, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për fillimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale 'Fushë-Kosova' dhe lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 10,000.00€ si kapital fillestar dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 22, të datës 20.01.2022 për fillimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale 'Fushë-Kosovës' dhe lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 10,000.00€, kapital fillestar për Ndërmarrjen Publike Lokale.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Ndërmarrjes Publike Lokale 'Fushë-Kosova' janë si vijon: mirëmbajtja e investimeve publike të komunës, parkut rekreativ në fshatin Sllatinë e Vogël, parqeve dhe hapësirave të vogla publike në qytet, hapësirave publike nëpër oborre të objekteve shkollore dhe objekteve shëndetësorë në qytet dhe nëpër fshatrat tona, palestrave dhe fushave të sportit, hyrjeve dhe daljeve të njësive banesore në ndërtesa, parkingjet dhe tregun.

Pika e shtatë (7) - Propozim për themelimin e tre Drejtorive të reja të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për themelimin e tre Drejtorateve të reja në Komunën e Fushë-Kosovës', ftoi Nënkyetarin e Komunës që të na jap sqarime.

Nënkyetari i Komunës: Themelimi i këtyre tre Drejtorive të reja të Komunës së Fushë-Kosovës, tani paraqitet si një nevojë e domosdoshme për funksionimin efektiv të komunës, e tillë është Drejtoria e Infrastrukturës Lokale, që e kanë shumicë e komunave, me qëllim të koncentrimit të projekteve publike në këtë drejtori dhe lirim të drejtorateve tjera, arsimit dhe shëndetësisë, nga puna me projekte kapitale dhe fokusimi i tyre në çështjet profesionale. Lidhur me Drejtorinë e Pronës, arsyeshmëria qëndron në faktin se parashihet që një pjesë e shërbimeve kadastrale dhe gjeodezike, planifikohet të mirren nga Agjencioni Kadastral i Kosovës, ne po tentojmë që të mbrojmë disa prona bujqësore dhe disa shërbime pronësore në aspektin juridikë, që synojmë të mbesin në interesin e përgjithshëm lokal dhe e treta Drejtoria për Teknologji Inovacion dhe Integritime Evropiane, përmes saj synojmë të arrijmë dixhitalizimin e shërbimeve komunale, në mënyrë më të avansuar, këto ndryshime ne do' t'i dërgojmë për vlerësim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Eglantina Azemi: Në këtë referencë tuajën për themelimin e tre Drejtorateve të reja Komunale, nuk po e shohin bazën ligjore, këtu së pari duhet të ndryshohet dhe plotësohet Statuti i Komunës, që duhet të cakton qartë detyrat dhe përgjegjësitë, por kjo punë po bëhet për pazare politike dhe rehatimin e njerëzve, në funksion të përmbysjes së premtimeve të Kryetarit të Komunës.

Mirsad Qyqalla: Grupi Parlamentarë i Partisë Demokratike të Kosovës, është i bindur se kjo punë nuk është e mbështetur në fakte, sepse punë të mira mund të kryhen edhe nga Drejtoritë aktuale të komunës, por kjo bëhet për realizimin e premtimeve, andaj ne jemi kundër, sepse ky propozim nuk mbështetet në nevojat reale të komunës, për zgjerim të kapaciteteve njerëzore.

Etnik Berjani: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim 'Propozimin e Kryetarit të Komunës për themelimin e tre Drejtorive të reja të Komunës', ne mendojmë se Drejtoria e Infrastrukturës Lokale, është shumë e nevojshme për të eliminuar dobësitë, në realizimin e projekteve publike në shumë fusha, kur kemi numër të madh të ndërtimeve të banesave kolektive, edhe Drejtoritë tjera të propozuara e kanë arsyeshmërinë e tyre, andaj ne e përkrahim për aprovim propozimin në fjalë.

Hasan Ismajli: Unë dua të ndërlidhem me fjalinë e Nënkyetarit të Komunës për arsyeshmërinë e themelimit të Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, sepse nuk ka nevojë të kemi shpenzime në shumën e mjeteve financiare prej: 90,000.00€, për shtruarjen e rrugëve me zhavor, kur mund të planifikohet e gjithë infrastruktura në zonat e ndërtimit në qytet. Projektet po bëhen por sa po na kushtojnë ato neve si komunë? Edhe Drejtoria e Pronës e ka arsyetimin e vetë, andaj unë jam për aprovimin e këtij propozimi.

Durim Hajra: Ky është një eksperimentë dhe gabim në hapa, ju po thuani se kompetencat e Drejtorive Komunale, i kemi bartur në 'Rregulloren për organizimin e brendshëm', për këtë rregullore ne nuk e kemi, nuk është as në ueb-faqën e komunës, kjo nuk është as parimore.

Driton Ademi: Unë jam këshilluar dhe e kam lexuar këtë Rregullore, në Ligjin për Pushtetin Lokal dhe Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, parashihet decentralizimi i pushtetit, kjo është një politikë e Ekzekutivit të Komunës, që kur e sheh të nevojshme për funksionimin efikas të sajë, propozon themelimin e Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale dhe Drejtorisë së Teknologjisë dhe Inovacionit, këtë e parasheh neni 43, shkronja (h) dhe kjo bëhet për arsye funksionale.

Durim Hajra: Kjo punë tani është absurde, ne ta marrim vendimin për themelimin e Drejtorive të reja Komunale, pa e ndryshuar Rregulloren për organizimin e brendshëm.

Driton Ademi: Kur të ndryshohet 'Rregullorja për Organizimin e Brendshëm të Administratës Komunale, shtohen drejtoritë e reja dhe kompetencat e tyre, ndryshimet vijnë, në demokraci vendos shumica.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për themelimin e tre Drejtorive të reja të Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', dhjetë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për themelimin e tre Drejtorive të reja të Komunës së Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 23 të datës 20.01.2022, për themelimin e tre Drejtorive të Komunës së Fushë-Kosovës si vijon: Drejtoria e Infrastrukturës Lokale, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Teknologji Inovacion dhe Integritet Evropiane.

Pika e tetë (8) - Propozim për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorëve të Shkollave në Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorëve të Shkollave në Fushë-Kosovë', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit që të na jap sqarime.

Drejtori për Arsim: Tani në konsultim me Zyrën Ligjore, para vetës ju e keni një propozim të ndryshuar, e kemi edhe një kërkesë nga Zyrtarja për Barazi Gjinore, që ta respektojmë edhe kriterin gjinorë. Ky Komision propozohet në bazë, të Udhëzimit Administrativ Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit, në një institucion publik arsimorë dhe procedurat për zgjedhjen dhe emërimin e tyre. Në këtë propozim parashihet të formohen Komisione për tre shkolla, ky konkurset publike i kemi të shpallura dhe procedurat duhet të zhvillohen brenda afateve kohore që parashihen me ligj. Në Komisione për secilën shkollë duhet të propozohen nga tre anëtarë, një drejtor i shkollës, një përfaqësues/e nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe një përfaqësues vjen nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit. Unë në tre Komisionet nga Drejtoria Komunale e Arsimit, e propozoi juristen znj. Miranda Sulejmani, ndërsa emërat e propozuar për anëtarë të Komisionit për Shkollën e Mesme të Lartë 'Hivzi Sulejmani' në Fushë-Kosovë, janë: Miranda Sulejmani, Sabri Xhigoli dhe përfaqësuesi i Mashtit, si dhe në cilësinë e vëzhguesit janë: Albert Kurtolaj dhe Besnik Musa, për anëtarë të Komisionit për Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë janë: Salih

Jashanica, Miranda Sulejmani dhe përfaqësuesi i Mashtit, si dhe në cilësinë e vëzhguesit janë: Gazmend Bekolli dhe Krenare Azizi dhe në fund për anëtarë të Komisionit për Shkollën Fillore të Mesme të Ulët 'Vëllezërit Frashëri' në fshatin Miradi e Poshtme janë: Gëzim Berisha, Miranda Sulejmani dhe përfaqësuesi i Mashtit dhe në cilësinë e vëzhguesit janë: Fisnik Sllamniku dhe Mirsad Drenovci. Unë ju ftoi që ta votoni propozimin në fjalë.

Remzi Shala: Tani 'Propozimi për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorëve të Shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës', përputhet me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 151/2020, për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit, në një institucion publik arsimorë dhe procedurat për zgjedhjen dhe emërimin e tyre, kjo punë definohet qartë në nenin 6, paragrafi 3, që duhet të jenë tre anëtarë, një nga Drejtoria Komunale e Arsimit, një ekspert i fushës së arsimit dhe një përfaqësues nga Mashti, tani me që të gjitha këto kushte janë plotësuar, në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, pajtohem që propozimi në fjalë të aprovohet.

Durim Hajra: Kjo punë është e pa qartë, propozimi është bërë me datën 10 janar 2022, pse nuk është rregulluar më herët, por tani në momentin e fundit bëhen këto ndryshime në emrat e personave, pse ta votojmë ne si Kuvend i Komunës, kur asnjë anëtarë i Komisionit nuk vjen nga Kuvendi i Komunës, këto propozime janë politike, në propozim ka edhe përfaqësues të partisë politike në pushtet, ne i kemi edhe dy rekomandime të daluara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të cilat nuk po mirren parasysh tani, ato duhet të vendosen në procedurën e votimit. Ne dyshojmë në punën e këtyre Komisioneve, andaj kemi propozuar që ta formojmë edhe një Komision mbikëqyrës të këtij procesi, kur paraprakisht po përfliken edhe emrat që do të përzgjidhen për Drejtor të Shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës.

Remzi Shala: Unë isha në siklet me propozimin e parë, që nuk ishte në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 151/2020, tani kur e kemi propozimin e dytë të Drejtorisë së Arsimit, unë nuk kam asnjë dilemë që këtë punë duhet ta bëjmë, sepse kështu e kërkon ligji, procesi zhvillohet sipas kriterëve të konkursit publik.

Mirsad Qyqalla: U thanë shumë fjalë dhe ato u sqaruan nga dy parafolësit e mi, ku proces duhet të jetë transparentë, duhet të përfillen procedurat ligjore, parimisht njerëzit mund të vijnë me bindje të ndryshme, por puna e Komisionit duhet të jetë profesionale dhe në përputhje me rregullat e konkursit. Ne e dimë se këto procese rrjedhin dhe zgjidhen politikisht, por kur dihen paraprakishtë personat dhe nuk lejohet transparencë përmes Komisionit mbikëqyrës, kjo punë nuk është në rregull, ju numrat i keni dhe mund të vazhdoni, ne nuk po kërkojmë asgjë në procesin e zgjedhjes, vetëm rolin monitorues, që të jemi shpirtërishtë në rregull me këtë punë, përndryshe, kjo është edhe e drejta jonë si opozitë.

Fisnik Sllamniku: Unë tani në fjalimin tim, dua të ndërlihem me konkursin për zgjedhjen e Drejtorëve të Shkollave të Komunës së Fushë-Kosovës, në bazë të normave ligjore një anëtarë duhet të jetë nga Drejtoria Komunale e Arsimit. Mua më kanë zgjedhur paneli i mësimdhënësve në cilësinë e vëzhguesit, sepse kështu e kërkon ligji, të jetë një përfaqësues nga shkollë dhe një përfaqësues i prindërve, në cilësinë e vëzhguesit, jo të anëtarit të Komisionit përzgjedhës, unë i përfaqësoi mësimdhënësit e shkollës në Vragoli, Miradi të Poshtme dhe Miradi të Epërme.

Migjen Kolshi: Unë jam për tetë vite anëtarë në Kuvendin e Komunës, tani jam në fillim të vitit të nëntë, propozimi për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorëve të Shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës, nuk ka ardhur asnjëherë në Kuvendin e Komunës për aprovim. Të gjitha partitë politike veprojnë njësoi, Vetëvendosja, PDK-ja, LDK-ja, ata i zgjedhin njerëzit e vetë, kjo punë dihet, nuk di pse po flisni fjalë pa vend, kur të gjithë e dini si veprohet në vendin tonë, ne mund të kërkojmë vetëm rolin e monitoruesit në procesin e zgjedhjes së Drejtorëve të Shkollave.

Durim Hajra: Unë nuk pajtohem me mendimin e parafolësit tim, procesi në fjalë është diskredituar deri tani, vetëm sa nuk është thënë nga ne, se do të zgjidhet Ganiu, por kjo punë nuk është e drejtë ndaj konkurentëve për këtë pozitë.

Migjen Kolshi: Sinqerisht kjo punë dihet si është, ju apo jetoni në Kosovë apo ku, kur nuk pajtohem nuk e votoi, por procesi rrjedhë, në demokraci vendos shumica.

Hasan Ismajli: Unë nuk i njoh këta persona që propozohen, andaj nuk mund të votoi dikend që nuk e njoh dhe nuk kam një mendim për të.

Laureat Gojnovci: Kjo nuk është në rregull të diskutohet në këtë mënyrë, të gjithë e njohim Sabri Xhigolin që është drejtor shkolle, njëjtë është puna edhe më Gëzim Berisha dhe Salih Jashanica, ju mund të thuani se kemi problem me vetëvetën, bile edhe bukur shumë, e jo të flisni palidhje dhe të akuzoni njerëzit pa kurrfarë justifikimi dhe arsytimi logjik.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne mund ta sqarojmë secilin person, për shëmbull Salih Jashanica është Drejtor në Shkollën ‘Zejnel Salihu’ në fshatin Bardh i Madh për dy vite, ne kemi drejtor të shkollave me përvojë, dhjetë apo njëzet vjeçare, e kemi Drejtoreshën e Shkollës së Lismirit znj. Shemsie Fetahu, ndyshime në komisione mund të bëjmë, nëse kemi vullnet, unë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kam patur hamendje dhe jam konsultuar, se ky propozim nuk është në përputhje me ligjin dhe duhet të bëhen përmirësime, kjo ka ndodhur, por prapë nuk pajtohem me disa emra në propozim dhe kërkesa ime është që të ndërrohen.

Drejtori për Arsimit: Dua të sqaroj se znj. Miranda Sylejmani është juriste në Drejtorinë Komunale të Arsimit, z. Sabri Xhigoli është drejtor në shkollën ‘Daut Bogujevci’ në Fushë-Kosovë, z. Salih Jashanica është drejtor shkolle në fshatin Bardh i Madh dhe z. Gëzim Berisha drejtor shkolle në fshatin Graboc i Poshtëm, unë ju ftoi që ta votoni propozimin në fjalë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë i kam analizuar emrat pa dyshim, ka edhe emra që janë anëtarë të Kuvendit të Komunës, që janë përfaqësues të subjekteve politike.

Durim Hajra: Në këtë rast duhet të shqyrtohen rekomandimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe baza ligjore për Komisionet.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim ‘Propozimin për formimin e tre Komisioneve për përzgjedhjen e Drejtorëve të Shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës’, me emra sipas propozimit të dytë të Drejtorisë së Arsimit.

U votua me: katërmëdhjetë vota ‘për’, njëmbëdhjetë vota ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm, pjesëmarrës në votim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për formimin e tre Komisioneve për përzgjedhjen e Drejtorëve të Shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisioneve për rekrutimin e Drejtorëve të Shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës, për konkursin e Shkollës së Mesme të Lartë 'Hivzi Sulejmani' në Fushë-Kosovë përzgjidhet Komisioni në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Miranda Sulejmani - Kryetare e Komisionit, përfaqësuese e Drejtorisë Komunale të Arsimit;
 - 1.2 Sabri Xhigoli - anëtar i Komisionit, drejtor në Shollën Filllore të mesme të Ulët 'Daut Bogujevci' në Fushë-Kosovë;
 - 1.3 Arian Mustafa - anëtar i Komisionit, nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit.
 - 1.4 Albert Kurtulaj - në cilësinë e vëzhguesit dhe
 - 1.5 Besnik Musa - në cilësinë e vëzhguesit.
2. Për konkursin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë përzgjidhet Komisioni në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
 - 2.1 Salih Jashanica - Kryetar i Komisionit, drejtor në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Zenel Salihu' në Bardh të Madh;
 - 2.2 Miranda Sylejmani - anëtare e Komisionit, përfaqësuese e Drejtorisë Komunale të Arsimit;
 - 2.3 Arian Mustafa - anëtar i Komisionit, nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit.
 - 2.4 Gazmend Bekolli - në cilësinë e vëzhguesit;
 - 2.5 Krenare Azizi - në cilësinë e vëzhgueses.
3. Për Konkursin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Vëllezërit Frashëri' në Miradi të Poshtme përzgjidhet Komisioni në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
 - 3.1 Gëzim Berisha - Kryetar i Komisionit, drejtor në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Laura Scotti' në Graboc të Poshtëm.
 - 3.2 Miranda Sylejmani - anëtare e Komisionit, përfaqësuese nga Drejtoria Komunale e Arsimit;
 - 3.3 Arian Mustafa - anëtar i Komisionit, nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit.
 - 3.4 Fisnik Sllamniku - në cilësinë e vëzhguesit;
 - 3.5 Mirsad Drenovci - në cilësinë e vëzhguesit.

Pika e nëntë (9) - Propozim për emërimin e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për emërimin e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete. Hap diskutimin.

Artan Asllani: Unë këtu dua ta shpreh pakënaqësinë time me Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, i cili nuk më është përgjigjur në kërkesën time, pas marrjes së materialit për mbledhje, kur e kam parë se në rendin e ditës në pikën e nëntë është 'Propozimin për emërimin e z. Suhat Ademi në pozitën e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete, menjëherë i'u jam drejtuar Kryesuesit të

Kuvendit të Komunës dhe Zyrtarit të Lartë për kuvend dhe Komitete, por nuk kam marrë ndonjë përgjigje, aty unë kam sqaruar se komunitetit ashkali sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, në Komunën e Fushë-Kosovës, është komuniteti më i madh nga radhët e komuniteteve jo shumicë dhe ka mbi tre mijë anëtarë, komunitetet tjera serb dhe egjiptian janë me vetëm mbi treqindë anëtarë, andaj kjo pozitë sipas ligjit dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2020 për emërimin e Nënkyetarëve të Komunave, i takon komunitetit ashkali. Unë nuk kam asgjë personale kundër z. Suhat Ademi, por kjo pozitë nuk u takon atyre në kundërshtim me ligjin, ata thirren në atë se janë regjistruar si Iniciativë e Fushë-Kosovës për Egjiptian dhe Ashkali në zgjedhje, por kjo nuk e ndryshon çështjen në fjalë. Unë kam komunikuar dhe i'a kam sqaruar në shtëpinë e tij, edhe përfaqësuesit të komunitetit serb këtu që vjen nga Lista Serbe z. Radoman Doderovic, se ky udhëzim është nënshkruar nga Ministri z. Goran Rakic, por ata janë tani një dhe presin ta votojnë jashtëligjshëm vendimin për emërimin e z. Suhat Ademi në pozitën Nënkyetarit të Komunës për Komunitete, por ky vendim do të kthehet në rishqyrtim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, njësoi si kur është vepruar me rastin e Komunës së Dragashit. Unë në mbledhjen e datës 03.12.2021, e kam votuar z. Bashkim Krasniqi, për pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, sepse kjo pozitë ju ka takuar atyre sipas rezultatit të zgjedhjeve, kjo pozitë është e rregulluar me ligj dhe udhëzim administrativ shumë qartë, andaj unë ju ftoi të gjithëve, që të mos e votoni një propozim të kundërligjshëm, udhëzimin e njeh mirë edhe doktor Remi. Edhe pse kolegët e mi nga radhët e komuniteteve, i kanë dërguar tre nënshkrime dhe kanë thënë, se do votojnë kandidatin e tyre për Nënkyetar të Komunës për Komunitete z. Suhat Ademi.

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Përshtendës të pranishmit në mbledhje. Unë po habitem ku e merrni të drejtën të paragjykoni vlerësimet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ne do ta votojmë propozimin në fjalë, ndërsa vlerësimin e bënë Ministria dhe jo ju i nderuar, andaj nuk mund të prejudikoni këtu.

Migjen Kolshi: Ju jeni dy subjekte politike, këtë punë nuk e definojnë subjekti politikë, por Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2020 për procedurën e emërimit të Nënkyetarëve të Komunës, neni 8 i tij e sqaron çështjen në fjalë, kjo pozitë i takon komunitetit më të madh në komunë, nga radhët e komuniteteve jo shumicë. Problemi këtu është se përveç votimit me shumicë të thjeshtë, nevojitet edhe shumica e dyfishtë.

Shpend Bardiqi: Ne e kemi konsultuar Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2020, për procedurat e emërimit të Nënkyetarëve të Komunës, aty shkruan saktë që kjo pozitë i takon komunitetit jo shumicë me numrin më të madh të banorëve në komunë, në rastin konkret komunitetit ashkali. Po ashtu, këtu ne nuk e kemi as biografinë e kandidatit të propozuar për pozitën e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete, me rëndësi është të sqarohet diçka kush është personi në fjalë.

Qëndresa Ademi: Atëherë unë vijë nga radhët e komunitetit ashkali dhe e mbështesë 'Propozimin që z. Suhat Ademi të emërohet në pozitën e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete', ne jemi një popull, nuk duhet të kemi ndarje të tilla, që burojnë nga historia dhe politika, ligji nuk e mohon që secili të deklarojë si kur të don ai vetë.

Artan Asllani: Nuk dua ta zgjasë shumë këtu debatin, unë e kam votuar personin e juaj për Zëvendës Kryesues të Kuvendit të Komunës për Komunitete, këto dy pozita nuk i takojnë

komunitetit egjiptian. Nuk e kuptoi qëndrimin tuaj, ne jemi kategori kushtetuese, origjina jona është nga Irani, ndërsa e egjiptianëve nga Exhipti. Vendimi që do ta merrni ju sot është i jashtëligjshëm.

Remzi Shala: Atëherë ne e kemi lexuar propozimin i cili është bërë, nga Kryetari i Komunës pas konsultimeve me komunitetet jo shumicë, ne nuk dëshirojmë të hyjmë në problemet tuaj politike dhe komunitare, por për votim ju e dini se nevojitet shumica e dyfishtë.

Hasan Ismajli: Unë këtu nuk po e shoh një dakordim, unë mendoj se nuk është urgjente kjo punë, unë mendoj se, sot ta mos e votojmë propozimin në fjalë, ta lejojmë një afat deri në mbledhjen e ardhshme, në mënyrë që komunitetet jo shumicë të mirren vesh.

Nënkryetari i Komunës: Për këtë vendim nevojitet shumica e dyfishtë, vendimi vlerësohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ne nuk mund të humbim muaj, deri në arritjen e marrëveshjes ndërmjet komuniteteve jo shumicë.

Artan Asllani: Ju mua po më vendosni në një pozitë të keqe, si anëtarë i Kuvendit të Komunës, sepse po merrni një vendim të paligjshëm, ne do të jemi këtu edhe për katër vite dhe kemi punë me të vlefshme, për përmirësimin e gjendjes së komuniteteve tona, andaj ju ftoi, që të mos e votoni propozimin në fjalë.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim ‘Propozimin për emërimin e z. Suhat Ademi në pozitën e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete’, duke sqaruar se për votimin e propozimit në fjalë, nevojitet të përmbushet kriteri i shumicës së thjeshtë prej katërmëdhjetë votave dhe shumica e dyfishtë e votave të komuniteteve jo shumicë në Kuvendin e Komunës, kështu është e definuar procedura.

U votua me: katërmëdhjetë vota ‘për’, një votë ‘kundër’ dhe dy abstenime, gjithësej në votim marrin pjesë shtatëmbëdhjetë anëtarë të Kuvendit të Komunës, dhjetë anëtarë nuk marrin pjesë në votim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave dhe me përmbushjen e votimit të dyfishtë, nga përfaqësuesit e komuniteteve në Kuvendin e Komunës, e aprovon ‘Propozimin për emërimin e z. Suhat Ademi në pozitën e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 24, të datës 20.01.2022 për emërimin e z. Suhat Ademi i lindur më datë 24.02.1975 me vendbanim në Fushë-Kosovë, përfaqësues nga Iniciativa e Fushë-Kosovës për Egjiptian dhe Ashkali, në pozitën e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës në mandatin zgjedhor 2021-2025.

Pika e dhjetë (10) - Propozim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores Komunale për Transparencë dhe Planit të Veprimit për Transparencë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores Komunale për Transparencë dhe Planit të Veprimit për Transparencë’, ftoi përfaqësuesin e subjekteve politike t’i japin propozimet për anëtarë të Grupit Punues.

Remzi Shala: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për anëtare të Grupit Punues, për hartimin e Projekt-Rregullores Komunale për Transparencë dhe Planit të Veprimit për Transparencë’, e propozojmë znj. Vjollca Konjusha.

Durim Hajra: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, për anëtarë të Grupit Punues, për hartimin e Projekt-Rregullores Komunale për Transparencë dhe Planit të Veprimit për Transparencë’, e propozojmë z. Vlonjat Hasani.

Mirsad Qyqalla: Në emër të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, për anëtare të Grupit Punues, për hartimin e Projekt-Rregullores Komunale për Transparencë dhe Planit të Veprimit për Transparencë’, e propozojmë z. Migjen Kolshi.

Pas diskutimeve për anëtarë të Grupit Punues, për hartimin e Projekt-Rregullores Komunale për Transparencë dhe Planit të Veprimit për Transparencë’, u propozua z. Hasan Ismajli.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim ‘Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për Transparencë dhe Planit të Veprimit për Transparencë’, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve si vijon: Ali Ismaili, Vjollca Konjusha, Vlonjat Hasani, Migjen Kolshi, Hasan Ismajli, Ali Topalli, Hasan Gjyrevci, Bardhyl Kojçiçi, Lindita Dervisholli Prebreza, Sllaxhana lazic dhe Maliq Thaqi.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi “Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për Transparencë dhe Planit të Veprimit për Transparencë”, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve si vijon: Ali Ismaili, Vjollca Konjusha, Vlonjat Hasani, Migjen Kolshi, Hasan Ismajli, Ali Topalli, Hasan Gjyrevci, Bardhyl Kojçiçi, Lindita Dervisholli Prebreza, Sllaxhana lazic dhe Maliq Thaqi dhe mori:

V E N D I M

1. Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Planit të Veprimit për Transparencë dhe Projekt-Rregullores për Transparencë, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës,
 - 1.2 Vjollca Konjusha - Përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - 1.3 Vlonjat Hasani - Përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.4 Migjen Kolshi - Përfaqësuesi i Partisë Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - 1.5 Hasan Ismajli - Përfaqësues i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, anëtar;
 - 1.6 Ali Topalli - Zyrtar për Informim, anëtar;
 - 1.7 Hasan Gjyrevci - Zyrtar i Lartë për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
 - 1.8 Bardhyl Kojçiçi - Shef për Planifikimin e Buxhetit, anëtar;
 - 1.9 Lindita Dervisholli Prebreza - Zyrtare e Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe barazi Gjinore, anëtar;
 - 1.10 Sllaxhana Lazic - Shefe e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtare dhe
 - 1.15 Maliq Thaqi - Përfaqësues i Shoqërisë Civile, anëtar.

Pika e njëmbëdhjetë (11) - Propozim për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për caktimin e dy anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës’. Hap diskutimin.

Remzi Shala: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, për mandatin zgjedhor 2021/2025, e propozojmë znj. Mirlinda Krasniqi.

Durim Hajra: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, për mandatin zgjedhor 2021/2025, e propozojmë z. Habib Mekolli.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim: ‘Propozimin për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës’, për mandatin zgjedhor 2021/2025, znj. Mirlinda Krasniqi dhe z. Habib Mekolli, me sqarimin se Ekzekutivi i Komunës përfaqësohet nga Kryetari i Komunës.

U votua me: njëzet e pesë vota ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe një abstenim, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi I Komunës me shumicë të votave e aprovoi ‘Propozimin për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës’, për mandatin zgjedhor 2021/2025, znj. Mirlinda Krasniqi dhe z. Habib Mekolli, me sqarimin se Ekzekutivi i Komunës përfaqësohet nga Kryetari i Komunës z. Burim Berisha dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, për mandatin zgjedhor 2021-2025.
2. Komunën e Fushë-Kosovës për Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës do ta përfaqësojnë:
 - 2.1 Burim Berisha - Kryetar i Komunës;
 - 2.2 Mirlinda Krasniqi - Përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës;
 - 2.3 Habib Mekolli - Përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje.

Pika e dymbëdhjetë (12) - Propozim për formimin e Grupit Punues për hartimin e projekt-Rregullores për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’, ftoi subjektet politike që të japin emrat për përfaqësim në këtë Grup Punues.

Durim Hajra: Grupi Punues i caktuar më herët ka qenë prej njëmbëdhjetë anëtarëve, mirëpo ai vendim është shfuqizuar, pa punuar fare.

Remzi Shala: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për anëtarë të Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, do të jem unë dhe Krenar Dumani.

Shpend Bardiqi: Në emër të Grupit parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, për anëtarë të Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e propozojmë z. Durim Hajra.

Migjen Kolshi: Në emër të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, për anëtarë të Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e propozojmë z. Mirsad Qyqalla.

Pas diskutimeve për anëtarë të Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, u propozua z. Bashkim Krasniqi.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim ‘Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve si vijon: Remzi Shala, Krenar Dumani, Durim Hajra, Mirsad Qyqalla dhe Bashkim Krasniqi, pesë anëtarë do ta caktohen nga Ekzekutivi i Komunës dhe një anëtarë nga Shoqëria Civile.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi ‘Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve si vijon: Remzi Shala, Krenar Dumani, Durim Hajra, Mirsad Qyqalla dhe Bashkim Krasniqi, pesë anëtarë tjerë, do ta caktohen nga Ekzekutivi i Komunës dhe një anëtarë nga Shoqëria dhe mori:

V E N D I M

1. Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për organizimin bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve si vijon:
 - 1.2 Remzi Shala - Përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - 1.3 Krenar Dumani - Përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - 1.3 Durim Hajra - Përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.4 Mirsad Qyqalla - Përfaqësues i Partisë Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - 1.5 Bashkim Krasniqi - Përfaqësuesi i Iniciativës së Fushë-Kosovës për Egjiptian dhe Ashkali, anëtar;
 - 1.6 Hasan Gjyrevci - Zyrtar i Lartë për Kuvend dhe Komitete, anëtar;

- 1.7 Ardit Sekiraqa - Zyrtar për Ndërtimtari dhe Mbikëqyrje, anëtar;
- 1.8 Bekim Rexha - Zyrtar për Regjistrim të Adresave, anëtar;
- 1.9 Besare Sllamniku - Zyrtar për Menaxhim Financiar dhe Kontroll, anëtar;
- 1.10 Ejup Qyqalla - Shef për Shërbime Publike, anëtar;
- 1.11 Rrahmon Stollaku - Përfaqësues i Shoqërisë Civile, anëtar.


Pika e trembëdhjetë (13) - Të ndryshme.

Kryesyesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Të ndryshme', ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që të marrin fjalën, nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 15:20 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

